



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 285/5 prot.

Tiranë, më 11.8.2020

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 256, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Etleva Deda
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 27.7.2020, është njoftuar vendimi nr. 256, datë 12.6.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Etleva Deda, me funksion gjyqtare në Gjykatën e Posaçme Kundër Krimit dhe Korrupsionit.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, unë, Komisioneri Publik Florian Ballhysa, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 256, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, aktualisht me funksion gjyqtare në Gjykatën e Posaçme Kundër Krimit dhe Korrupsionit, në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1<sup>1</sup> e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit znj. Etleva Deda ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si *ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si *DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim referuar si *KLJGJ*), nga të cilat rezulton se:

2.1 **ILDKPKI**, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Etleva Deda*”, ka referuar për subjektin se:

- i. Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ii. Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. Nuk ka kryer deklaram të rremë;
- v. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2 **DSIK**, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, znj. Etleva Deda<sup>2</sup>, i ka referuar Komisionit: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva \*\*\* Deda”.

2.3 **KLJGJ**, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, dosjeve të përzgjedhura me short dhe të dhënave nga burimet arkivore, përmes shkresës nr.\*\*\*, datë \*\*\*.7.2019, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për aftësitë profesionale.

3. Për sa më sipër, përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, hetimi administrativ i Komisionit është shtrirë në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramëve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ligjshmërinë e të ardhurave, shpenzimet etj., për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të. Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar provat dhe faktet e dala nga hetimi administrativ, provat dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: *[...]Në përfundim, trupi gjyqësor, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në konkluzionin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht dhe se ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme dhe nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të*

<sup>1</sup> Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, DH dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

<sup>2</sup> Raporti me nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. \*\*\*, datë \*\*\*.1.2019.

interesit. Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Subjekti është treguar bashkëpunues gjatë gjithë periudhës së hetimit. kryesisht duke iu përgjigjur pyetësorit të dërguar, si edhe pyetjeve shtesë në një kohë të shpejtë dhe duke dhënë në mënyrë të besueshme dhe shteruese informacionin e kërkuar[...] (f. 34 e vendimit). Në këto kushte, trupi gjykues i Komisionit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, bazuar në nenin 4, pika 2, si dhe nenin 59/1, germa “a”, të ligjit nr. 84/2016, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

**3.2 Për kontrollin e figurës.** Referuar nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në konsideratë të verifikimit dhe të konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për përshtatshmërinë e subjektit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Gjithashtu, nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës [...] (f. 35 e vendimit).* Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Etleva Deda, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

**3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, të ndryshuar, Komisioni, pasi ka administruar raportin e përgatitur nga KLGJ, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, ka arritur në përfundimin se: [...] *Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë” [...] (f. 36 e vendimit).* Për sa më sipër, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

**4. Vendimi i Komisionit.** Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

6. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit kontrollues/rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

7. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij, për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

8. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

9. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 256/2020, çmon se ai është i cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Lidhur me rrethanat ligjore e të faktit, sikurse do të trajtohet edhe në vijim, Komisioneri Publik i referohet edhe jurisprudencës së Kolegjit, i cili, bazuar në nenin F të aneksit të Kushtetutës, është organi i vetëm gjyqësor që vendos për vlerësimin përfundimtar të këtyre çështjeve.

10. Nisur nga hetimi dhe vlerësimi që ka kryer Komisioni për të tria kriteret e rivlerësimit, ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton si çështje për gjykim rezultatet e hetimit administrativ, për të cilat subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës dhe për të cilat Komisioneri Publik çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë të kundërtën.

11. Ankimi i Komisionerit Publik, në rastin konkret, evidenton dhe parashtron rrethana dhe fakte ligjore, lidhur me: (i) deklarime të pasakta/pamjaftueshme lidhur me posedimin e likuiditeteve *cash* ndër vite nga ana e subjektit, që kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë; (ii) pamjaftueshmërinë e të ardhurave të ligjshme për të mbuluar kursimet dhe shpenzimet e deklaruar; (iii) burimin e ligjshëm të dhuruesit, z.\*\*\*.\*\*\*, për të dhuruar shumën 15.000 euro; si dhe (iv) pamjaftueshmërinë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e pasurisë të llojit apartament banimi me sip. 115 m<sup>2</sup>, në Tiranë.

12. Në referencë të përmbajtjes të nenit 4, pika 2, të nenit 59, pika 1 dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik çmon se gjykimi i rrethanave ligjore dhe i fakteve të mësipërme nga ana e Kolegjit është i nevojshëm, me qëllim për të arritur në një vendimmarrje të Kolegjit, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

13. Në përfundim të sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 2 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ankimon vendimin nr. 256, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

### III. Analiza e shkaqeve të ankimit

#### III. A. Kontrolli i pasurisë

14. Përsa i takon rivlerësimin të kriterit të pasurisë, referuar nenin D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimin, objekti i hetimit dhe i vlerësimin të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimin duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

15. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave periodike vjetore me Deklaratën “Vetting”, referuar nenin 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të aneksit të Kushtetutës, për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramin dhe burimit të ligjshëm të pasurive, rezulton si vijon:

16. **Pasuria “Apartament me sip. 107,5 m<sup>2</sup>”, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*.\*\*\*”, Tiranë (në vijim referuar si “Apartament me sip.115 m<sup>2</sup>”, sipas sip. të parashikuar në kontratën e porosisë, të referuar dhe në vendimin e Komisionit)**

16.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimin, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Më 9.10.2009 kam lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. kontratën e porosisë me nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., ku kam porositur ndërtimin e një apartamenti banimi me sip.115 m<sup>2</sup>, në katin e pestë të banimit, në rrugën “\*\*\*\*.\*\*\*”, Tiranë. Shuma e përgjithshme e apartamentit është 92.000 euro, 800 euro m<sup>2</sup>. Sipas kontratës së shitblerjes nr.\*\*\* rep./kol., datë \*\*\*.12.2011, nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., kam blerë një apartament banimi nr.\*\*\*, me sip.107,5 m<sup>2</sup>, në vlerën 92.000 euro [...].*

16.2 Kësti i parë është paguar më datë 9.10.2009, në vlerën 72.000 euro, me lidhjen e kontratës së porosisë nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.10.2009.

16.3 Kësti i dytë është paguar më datë 17.11.2011, në vlerën 20.000 euro, sipas deklaratës noteriale nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2011, lidhur mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimin, në të cilën deklarohet nga palët shlyerja totale e çmimit<sup>3</sup>.

16.4 Në lidhje me burimin e të ardhurave për pagesën e vlerës prej 92.000 euro, subjekti ka deklaruar këto zëra të ardhurash:

(i) *Kredi nga \*\*\* Bank, në shumën 5.000.000 lekë në vitin 2006, sipas Kontratës së Kredisë nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.9.2006;*

(ii) *Të ardhura nga paga, të siguruara nga puna, ndër vite;*

(iii) *Dhuratë nga prindërit, në shumën 15.000 euro (ose 2.057.550 lekë); në vitin 2009, sipas Deklaratës Noteriale nr.\*\*\* rep./ kol., datë \*\*\*.4.2011;*

<sup>3</sup>Subjekti i rivlerësimin në shpjegime të rezultateve të hetimit ka deklaruar se në momentin e likuidimit të gjithë shumës prej 92.000 euro, ka hartuar kontratën e shitblerjes nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.12.2011.

- (iv) Të ardhura në vlerën 250.000 lekë nga shitja e njësisë së shërbimit me sip. 26,12 m<sup>2</sup>, Durrës, në vitin 2007 (deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007), së bashku me prindërit dhe motrën \*\*\*,\*\*\*, shtetasit \*\*\*,\*\*\* (në vlerën 1.000.000 lekë – pjesa takuese 250.000 lekë), me kontratën nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.12.2007;
- (v) Të ardhura në vlerën 13.750 euro nga shitja e njësisë së shërbimit me sip. 47,7 m<sup>2</sup>, Durrës, në vitin 2013, së bashku me prindërit dhe motrën \*\*\*,\*\*\*, shtetasve \*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\*, në vlerën totale 55.000 euro, me Kontratën me Rezervë me afat, nr.\*\*\* rep./ \*\*\* kol., datë \*\*\*.7.2013. Burimi: apartamenti i privatizuar në vitin 1994, kthyer në dyqan;
- (vi) Dhuratë nga babai, \*\*\*,\*\*\*, të vlerës 4.000 euro, në vitin 2011 (deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011), sipas Deklaratës noteriale nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2011;
- (vii) Hua në vlerën 8.000 euro (ose 1.106.400 lekë) në vitin 2011, deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, nga shtetasja \*\*\*,\*\*\* (vjehrra e xhaxhait \*\*\*,\*\*\*) sipas Kontratës së huas nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.11.2011.

16.5 Në DV-2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] Më 9.10.2009 kam lidhur me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. kontratën e porosisë me nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., ku kam porositur ndërtimin e një apartamenti banimi me sip. 115 m<sup>2</sup>, në katin e pestë të banimit, në rrugën “\*\*\*.\*\*\*”, Tiranë. Shuma e përgjithshme e apartamentit është 92.000 euro, 800 euro m<sup>2</sup>. Pjesa takuese: 100% [...]. Subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë.

16.6 Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, përmes shkresës nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2019, konfirmon se në emër të shtetasës Etleva \*\*\* Deda figuron e regjistruar pasuria volum \*\*\*, faqe \*\*\* z. k., \*\*\*, lloji i pasurisë apartament me sipërfaqe 107.5 m<sup>2</sup>.

16.7 Në përfundim të hetimit administrativ mbi këtë pasuri, Komisioni, ndër të tjera, ka vlerësuar se: [...]...pavarësisht pasaktësive të konstatuara në deklaratimet periodike vjetore, lidhur me deklarimin mbi gjendjen cash dhe kundërshtive të konstatuara mes të dhënave lidhur me deklarimin e gjendjes deri më 31 dhjetor dhe deklarimit nga vetë subjekti mbi përdorimin e kursimeve për blerjen e apartamentit, i cili është në një datë më të shpejtë, të gjitha faktet e servirura mbeten të lidhura mes tyre dhe justifikojnë deklaratimet e subjektit se ato kursime janë përdorur për blerjen e apartamentit (pagimin e kësteve përkatëse) ....Në vlerësim të sa më sipër, megjithëse Komisioni i gjen deklaratimet periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjendjen cash dhe përdorimin e tyre, jo në përputhje me ligjin nr. 9049/2003, në përfundim vlerëson se ato janë pasaktësi të paqëllimshme dhe se deklaratimet e subjektit në deklaratën “Vetting” ndihmojnë për të kuptuar drejt deklaratimet e tij ndër vite [...] ( f. 26, prg. 99).

16.8 Po ashtu, Komisioni, ndër të tjera, në prg. 113, f. 28 të vendimit përkatës ka konkluduar se: [...] Në vlerësimin e Komisionit, në konsekuencë edhe të qëndrimeve tashmë të konsoliduara, të mbajtura nga Kolegji <sup>4</sup>, pasaktësitë në deklarime nuk mund të shërbejnë si shkelje të tilla, që të formojnë bazën e duhur ligjore për shkarkim [...].

16.9 Komisioneri Publik çmon se, për qëllim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë, konkluzionet e Komisionit mbi rezultatet e hetimit për këtë vendim, nuk gjejnë mbështetje në praktikën e Kolegjit, mbi përcaktimet e dispozitave kushtetuese dhe ligjore për procesin e

---

<sup>4</sup> Komisioni i është referuar vendimit (JR) nr.11/2018, T. N. dhe (JR) nr. 5/2019, A. C., subjekte këto që me vendim të Komisionit janë shkarkuar nga detyra.

rivlerësimi për kriterin e pasurisë, si dhe as në rezultatet e hetimit administrativ të dokumentuara në përmbajtjen e akteve në dosje.

**17. Lidhur me praktikën e Kolegjit.** Në referencë të përfundimit të arritur nga Komisioni se [...] *pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore lidhur me gjendjen cash dhe përdorimin e tyre, jo në përputhje me ligjin nr. 9049/2003 janë pasaktësi të paqëllimshme dhe se deklaratimet e subjektit në deklaratën “Vetting” ndihmojnë për të kuptuar drejt deklaratimet e tij ndër vite [...], Kolegji, në vendimin (JR) nr. 6/2018, në prg. 17, mbi pretendimin e subjektit se ka kryer vetëm pasaktësi teknike dhe të paqëllimshme, pa dashje, arsyeton se: [...] *Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklaratimit me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit. Në këtë proces subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016, në pjesën informuese të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit, subjektet janë informuar mbi sanksionet në rast mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi të saj. Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal), i cili ofron të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor. Në lidhje me deklarinë e pasurisë, ligji nuk ka pasur në qëllim të tij përcaktimin e rrethanave lehtësuese apo rënduese, të lidhura me dashjen apo qëllimin, pasi në të kundërt do të kishte bërë përcaktime të tilla, si në nenin 38 për standardet e kontrollit të figurës[...].**

17.1 Komisioneri Publik, duke iu referuar argumentimit të Kolegjit në vendimin (JR) 19/2019, prg. 22.14, vlerëson se kontrolli i Deklaratës “Vetting” dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, vlerësohet si mjet që shërben gjatë procesit të rivlerësimit për kriterin pasuror, për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij. Kjo merr vlerë specifike, sidomos në rastin e vlerësimit të ligjshmërisë së burimeve të krijimit të një pasurie, pasi këtu paraqitet deklarimi i subjektit në momentin e krijimit të pasurisë, si dhe transaksionet e kryera në vite me këtë pasuri<sup>5</sup>.

17.2 Në vendimin e Kolegjit (JR) nr. 9/2018, në prg. 42 të tij, shprehet: [...] *...Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit arsyeton se, duke u nisur nga sa parashikon Kushtetuta dhe ligji për plotësimin e Deklaratës “Vetting” dhe shprehjes së ILDKPKI-së për konstatimet në këto deklarime, nuk e përjashton Komisionin apo Kolegjin nga kontrolli i këtyre deklaratimeve, të cilat jo pa qëllim i dërgohen që nga viti 2003. Dispozitat ligjore që rregullojnë vlerën e deklaratimeve të bëra në deklaratat periodike dhe deklaratën e pasurisë së rivlerësimit janë neni Ç, pika 4 dhe neni D i aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. ...Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “Deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit”. Ndërkohë, sipas nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me procesin e rivlerësimit të pasurisë, objekti i këtij vlerësimi është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të, elemente këto të cilat rezultojnë edhe nga deklaratimet periodike të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit. Duke*

---

<sup>5</sup> Kolegji ka trajtuar gjerësisht dhe në vendime të tjera vlerën e Deklaratës “Vetting” në raport me deklaratat periodike vjetore, dhe rëndësinë e deklaratimeve periodike në rivlerësimin e kriterit të pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit.

qenë se përcaktimet kushtetuese dhe ligjore të sipërcituara u kanë dhënë deklarimeve periodike të pasurisë vlerën e provës, ato mund të konsiderohen të së njëjtës rëndësi me deklaratën e pasurisë “Vetting”. Komisioni apo Kolegji, këto deklaratë, së bashku me provat e tjera, i vlerëson në tërësi me rrethanat e çështjes për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë. Përveç kësaj, Komisioni ushtron kontroll edhe mbi aktin administrativ që është raporti i ILDKPKI-së për provueshmërinë dhe vërtetësinë e tij [...].

17.3 Arsyetimi i mësipërm është mbështetur edhe më gjerë në jurisprudencën e Kolegjit për interpretimin dhe zbatimin e nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ku Kolegji ka trajtuar në disa vendime detyrimin për deklarim dhe vlerën provuese të deklaratave periodike vjetore, konkretisht në vendimin (JR) nr. 6/2018, prg.14; vendimin (JR) nr. 8/2018, prg. 43; vendimin (JR) nr. 11/2018, prg. 17,17.5 dhe në vijim; vendimin (JR) nr.12/2018, prg. 24.11; vendimin (JR) nr. 5/2019, prg. 23; vendimin (JR) nr. 10/2018 prg. 67, si dhe vendimin (JR) nr. 19/2019, prg. 22.14.

17.4 Kolegji, në vlerësim të rëndësisë të saktësisë së deklarimeve vjetore, të cilat janë plotësuar nga subjektet në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, në vendimin (JR) nr. 4/2020, në prg. 64.2 dhe prg. 64.3, ndër të tjera, argumenton: [...] *Sipas ligjit nr. 9049/2003, deklaratat periodike të interesave private janë dokumente zyrtare që plotësohen periodikisht, me vullnet dhe ndërgjegje të plotë nga subjektet deklaruese dhe, për pasojë, sjellin përgjegjësi për vërtetësi për zyrtarin/subjektet e rivlerësimit, në të kundërt deklaratat është e rreme. Procesi i deklarimit, po sipas së njëjtës bazë ligjore, është nga natyra i vazhdueshëm dhe i përbërë nga hallka të një zinxhiri, pasuria e krijuar në vitet paraardhëse shërben si burim krijimi për pasurinë në vitet pasardhëse. Për këtë arsye, deklaratat e pasurisë dhe kontrolli i interesave nuk janë dokumente të izoluara, por pjesë e një zinxhiri/procesi të rregullt që, siç përcaktohet në ligj, ka për qëllim të monitorojë deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta. Si shembull, pasuria e pambuluar me burime të ligjshme në njërin nga deklaratat periodike vjetore, mbetet e tillë për gjithë periudhën deklaruese për një subjekt, deri në vitin 2016. Me fjalë të tjera, kalimi i viteve nuk ka asnjë efekt shues, pasuria e deklaruar pasaktësisht apo burimet e ligjshme të munguara mbeten në thelb me të njëjtat probleme si edhe në fillim. Nëse një subjekt blen pasuri në vitin 2011 apo 2012 me të ardhura të cilat nuk mbulohen nga burime të ligjshme që rrjedhin nga viti 2003 apo 2004, pasuritë mbeten të krijuara me burime të paligjshme, pavarësisht nga kalimi i kohës. Mungesa e burimit të ligjshëm qëndron. Si pasojë, edhe deklarimi i paplotë dhe i pasaktë përbëjnë veprime që nga natyra janë të vazhdueshme, mbi të cilat parashkrimi ligjor dhe tipik i shkeljeve të tjera disiplinore nuk gjen zbatim [...].*

17.5 Nga aktet e administruara në fashikullin e vendimit nr. 256/2020, akte të ILDKPKI-së, Komisioneri Publik konstaton se problemi i pasaktësive, mungesës së deklarimit dhe dokumentacionit shoqërues në deklaratat periodike vjetore nga ana e subjektit, është konstatuar edhe nga ILDKPKI. Ky institucion, përmes shkresës nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2019, ka përcjellë pranë Komisionit kopje të procesverbaleve të mbajtura pranë ILDKPKI-së për këtë subjekt rivlerësimi ndër vite, për këto prolematika të vërejtura.

**18. Lidhur me rezultatet e hetimit administrativ për vlerësimin e kriterit të pasurisë.** Komisioni, në vendimin nr. 256/2020, si konkluzion për rubrikën e vlerësimit të pasurisë, ka vlerësuar: [...] *bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në konkluzionin se*



nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht dhe se subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme<sup>6</sup> [...].

**19.** Komisioneri Publik çmon se këto konkluzione të Komisionit nuk janë të sakta, pasi nuk bazohen në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala nga aktet e administruara në dosje. Në vijim të arsytimit parashtrijmë qëndrimin për të cilat Komisioneri Publik ndan vlerësim të ndryshëm nga Komisioni.

**20.** Lidhur me zërin: Kredi nga \*\*\* Bank, në shumën 5.000.000 lekë, deklaruar në D-Vett., si një nga burimet e pasurisë apartament me sip.115 m<sup>2</sup>

20.1 Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, me datë \*\*\*.9.2006, ka lidhur me \*\*\* Bank (në vijim referuar si \*\*\*), kontratë kredie për blerje apartamenti, në vlerën 5.000.000 lekë. Subjekti deklaroi shlyerjen e kësaj kredie dhe vlerën e mbetur të detyrimit në deklaratat periodike vjetore të mëpasshme dhe në D-Vett.

20.2 \*\*\*, me shkresën nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.2.2019, drejtuar Komisionit, konfirmon se subjekti i rivlerësimit është kredimarrëse pranë kësaj banke, për një kredi të marrë në datën \*\*\*.9.2006, në shumën 5.000.000 lekë. Detyrimi i pashlyer deri në datën \*\*\*.2.2019 është 676,179.41 lekë.

20.3 Rezulton se subjekti i rivlerësimit me kontratën noteriale të kredisë bankare dhe hipoteke nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.9.2006, ka përfituar kredi në vlerën 5.000.000 lekë, nga \*\*\*, me qëllim blerje apartamenti. Subjekti i rivlerësimit ka aplikuar dhe ka përfituar kredi me kushte lehtësuese në zbatim të akteve ligjore në fuqi, në zbatim të marrëveshjes së lidhur ndërmjet \*\*\* dhe Ministrisë së Financave të RSH-së nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2005, për trajtimin me strehim të funksionarëve të lartë të shtetit.<sup>7</sup>

20.4 Në lidhje me kredinë e butë në vlerën 5.000.000 lekë, referuar lëvizjeve të llogarive bankare, të subjektit të rivlerësimit, në \*\*\* dhe \*\*\* Bank, rezulton se:

- (i) më datë \*\*\*.9.2006, në llogarinë e pagës së subjektit të rivlerësimit pranë \*\*\*, është disbursuar kredia në shumën 5.000.000 lekë;
- (ii) më datë \*\*\*.11.2006, kjo shumë është transferuar në llogarinë bankare rrjedhëse të hapur pranë \*\*\* në emër të subjektit, me përshkrimin: “Derdhje marrje kredie nga \*\*\*”;
- (iii) më datë \*\*\*.2.2007, subjekti ka tërhequr nga \*\*\*, *cash*, shumën 2.500.000 lekë;
- (iv) më datë \*\*\*.2.2007, subjekti ka tërhequr nga \*\*\*, *cash*, shumën 1.000.000 lekë;
- (v) më datë \*\*\*.4.2007, është kredituar në llogarinë e subjektit në \*\*\* shuma prej 2.500.000 lekë, me përshkrimin “\*\*\*.\*\*\* për \*\*\*.\*\*\*, kthim borxhi”<sup>8</sup>;
- (vi) më datë \*\*\*.4.2007, subjekti ka tërhequr nga \*\*\*, *cash*, shumën 2.000.000 lekë;
- (vii) më datë \*\*\*.4.2007, subjekti ka tërhequr *cash* shumën 2.000.000 lekë dhe është zëruar llogaria në \*\*\*.

20.5 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat periodike gjendje të llogarisë bankare pranë \*\*\* Bank në 31 dhjetor të vitit 2006, si dhe transaksionet e kryera<sup>9</sup>. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, f. 5, deklaroi se: [...] *shumën e tërhequr (pra shumën e kredisë së marrë) e kam mbajtur gjendje cash në shtëpi, në pritje të realizimit të*

<sup>6</sup> Referohuni f. 34 të vendimit, konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë.

<sup>7</sup> Për sigurimin e kredisë, nga ana e subjektit të rivlerësimit është lënë garanci hipotekore një apartament me sip.144 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Durrës, në pronësi të z.\*\*\*.\*\*\* dhe bashkëshortes së tij, znj.\*\*\*.\*\*\* (tezja dhe bashkëshorti i tezes së subjektit).

<sup>8</sup> Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se këtë shumë ia ka dhënë hua shtetasit \*\*\*.\*\*\*, në muajin shkurt 2007, i cili ia ka rikthyer dy muaj më vonë.

<sup>9</sup> Sa më sipër është pyetur nga ILDKPKI në procesverbalin e mbajtur me datë \*\*\*.4.2011.

qëllimit për të cilin kisha marrë kredinë. Këtë shumë e kam përdorur në vitin 2009, për pagimin e këstit të parë të apartamentit në rrugën “\*\*\*.\*\*\*”, Tiranë [...].

20.6 Subjekti i rivlerësimit, në DV - 2007-2008, deklaroi shtesa të kursimeve, respektivisht: (i) 350.000 lekë kursime nga paga deri në 31 dhjetor për vitin 2007; (ii) 250.000 lekë, si pjesë takuese ¼ nga shitja e njësisë së shërbimit me sip. 26.15 m<sup>2</sup>, Durrës, në bashkëpronësi me prindërit dhe motrën, sipas kontratës \*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.12.2007; (iii) 300.000 lekë kursime nga paga nga janari deri në dhjetor 2009.

20.7 Nga sa më sipër, rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar, në DV - 2007-2008, posedimin e likuiditeteve cash të tërhequra nga llogaria e kredisë gjatë viteve 2007 dhe 2008, në vlerën totale 5.000.000 lekë.

20.8 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 21.1.2020, të dhëna gjatë hetimit administrativ dhe të administruara në fashikullin e Komisionit ka deklaruar se: [...] *Pavarësisht se shumën e kredisë e kam patur gjendje cash në banesë, e kam vlerësuar si fakt të deklaruar, duke qenë se kredinë bankare e kam deklaruar në deklaratat e interesave private periodike/vjetore, nga viti 2006 dhe deri më sot, në zërin: “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, si dhe për faktin se unë nuk kam kryer asnjë veprim juridik gjatë kësaj periudhe [...]*<sup>10</sup>.

20.9 Ndërkohë, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit, f. 4, ka deklaruar se: [...] *Në lidhje me diferencën negative<sup>11</sup>, konstatuar prej Jush, Ju bëj me dije se edhe unë, sikurse shumica e popullsisë, këmbimin e lekut në euro, e kam kryer në momentet më të volitshme, duke ndjekur kursin e këmbimit. Si shumën e kredisë, edhe të ardhurat nga shitja e dyqanit në datën \*\*\*.12.2007, ashtu edhe kursimet nga paga ndër vite, i kam konvertuar nga lekë në euro në kohë të ndryshme, duke ndjekur kursin e këmbimit në favor të euros. Aktualisht nuk mund të përcaktoj se me sa i kam këmbyer (kjo pasi jo vetëm që është kohë e largët, por edhe se është veprim i kryer në shuma të ndryshme në kohë të ndryshme [...].*

20.10 Subjekti i rivlerësimit në komunikimet elektronike me ILDKPKI, të administruara në dosje të Komisionit, lidhur me pagesën e këstit të parë të pasurisë apartament me sip.115 m<sup>2</sup>, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Në këstin e parë përfshihet kredia e marrë për këtë qëllim në v. 2006, e cila është konvertuar nga lekë në euro dhe anasjelltas në varësi të kursit të këmbimit valutor, duke qenë se e disponoja në cash [...].*

20.11 Komisioni, në vijim të problematikave të konstatuara lidhur me pasqyrimin e gjendjes cash në banesë të shumës së marrë kredi, ka vlerësuar se: [...] *Pasaktësitë në deklaratat periodike të viteve 2007 dhe 2008, lidhur me pasqyrimin e gjendjes cash në banesë të shumës së marrë kredi, nuk mund të konsiderohen si të tilla që të ngrenë dyshime mbi ekzistencën apo ligjshmërinë e këtij burimi, për aq kohë sa provohej se ajo shumë e disbursuar prej \*\*\* Bank në vitin 2006 është transferuar në \*\*\* Bank<sup>12</sup> dhe tërhequr cash nga subjekti në vitin 2007, disponohej në fund të atij viti pasi nuk rezultoi e shpenzuar as në deklaratat periodike dhe as gjatë hetimit administrativ të Komisionit. Po ashtu, subjekti e ka deklaruar këtë shumë si detyrim, nëpërmjet deklaratave periodike vjetore dhe të përdorur si burim për blerje apartamenti në vitin 2009 [...].*

<sup>10</sup> Subjekti i rivlerësimit ka dhënë të njëjtën përgjigje dhe në shpjegime të rezultateve të hetimit, referohuni f.10.

<sup>11</sup> Referuar rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni, në analizë të mundësisë financiare të subjektit që me të ardhura të ligjshme të paguajë këstin e parë të apartamentit, në vitin 2009, ka konstatuar një diferencë negative prej -518.690 lekë.

<sup>12</sup> Nga aktet në dosje rezultoi se kredia është disbursuar në llogari pranë bankës \*\*\* dhe jo në \*\*\* Bank.

20.12 Komisioneri Publik, nisur nga vlera provuese që marrin deklaratat vjetore të subjekteve të rivlerësimit, në referencë të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, çmon se në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojë vlerën e likuiditeteve gjendje në *cash*, jashtë sistemit bankar në lekë ose valutë të huaj, si dhe çdo ndryshim të këtyre vlerave.

20.13 Kolegji, në vendimin (JR) nr. 7/2019, prg. 39, bazuar në nenin 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ndër të tjera, ka orientuar Komisionin që: [...] të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike [...].

20.14 Subjekti i rivlerësimit, pas tërheqjeve nga llogaritë bankare, të shumës prej 5.000.000 lekë, të kryer në vitin 2007, nuk rezulton të ketë deklaruar në asnjë prej DV-ve të mëvonshme 2007-2008, posedimin e tyre *cash* në banesë ose përdorimin e tyre, në lekë apo në euro, duke bërë kështu të pamundur gjurmimin e këtyre të ardhurave gjatë viteve përkatëse.

20.15 Komisioneri Publik, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, lidhur me burimin e të ardhurave të deklaruara si zë për shlyerjen e këstit të parë në shumën prej 5.000.000 lekë, si e ardhur nga kredia me kushte lehtësuese, e marrë në vitin 2006, vlerëson se subjekti ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

20.16 Komisioneri Publik vlerëson po ashtu se edhe në kushtet kur subjekti eventualisht justifikon në kuptimin formal kriteret e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për marrjen e kredisë me kushte lehtësuese, mbetet e pajustificuar dhe e padrejtë në vlerësimin e etikës së subjektit të rivlerësimit, fakti që subjekti i rivlerësimit ka përdorur vlerën e saj për të përfituar nga konvertimi i monedhave për periudhën në fjalë, përfitime të cilat nuk i ka dokumentuar dhe deklaruar në asnjë nga deklaratat periodike vjetore.

20.17 Në vështrimin e Komisionerit Publik, veprimet e mësipërme, të padokumentuara dhe të padeklaruara, të kryera nga subjekti i rivlerësimit për qëllim krijimin e të ardhurave shtesë, duke përdorur shumën e përfituar si kredi me kushte lehtësuese, janë në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një magjistrat dhe cenojnë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

20.18 Në përfundim, lidhur me burimin e dekluar, të ardhura nga kredia, përdorur për pasurinë “Apartament me sip. banimi 115 m<sup>2</sup>”, vlerësojmë se në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b”, nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

20.19 Konkluzionet e mësipërme mbështeten edhe në qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit, mbi interpretimin dhe zbatimin e nenit D të aneksit të Kushtetutës, në veçanti lidhur me kuptimin e pasurisë së ligjshme, e ndërlidhur me momentin e deklarin në deklaratat periodike të likuiditeteve<sup>13</sup>.

## **21. Lidhur me zërin: Të ardhura nga paga të siguruar nga puna, ndër vite, deklaruar si një nga burimet e pasurisë apartament me sip.115 m<sup>2</sup>**

<sup>13</sup> Referohuni në pikën 27.12.18 të prg. 27, vendim (JR) nr. 11/2019; prg. 84, vendim (JR) nr. 19/2019; prg.59, vendim (JR) 20/2019 dhe prg. 31, vendim (JR) nr. 29/2019 të KPA-së.

21.1 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e dhëna në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit, f.11, mbi kursimet *cash* të deklaruara, është shprehur se: [...] *Kursimet nga paga, për periudhën e punës si gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, pasqyrojnë kursimet nga paga për periudhën nga 1 janari i vitit për të cilin i kam deklaruar deri më 31 dhjetor të atij viti. Ato kursime i kam mbartur në vitin pasardhës, por në kushtet që i kam deklaruar në vitin e krijimit, nuk janë ridekluar përsëri si gjendje cash. Kursimet nga paga, të siguruara prej meje deri në vitin 2009 (duke përfshirë edhe kursimet e atij viti), i kam zeruar në vitin 2009, për pagimin e këstit të parë të blerjes së apartamentit në pronësinë time, në Tiranë. ...Kursimet e deklaruara për vitet 2009 dhe 2011, pavarësisht se nuk i kam pasur gjendje cash në 31 dhjetor të viteve respektive, pasi i kam shpenzuar (përdorur) si më sipër, i kam deklaruar, pasi me ato kursime kam likuiduar pjesërisht këstet respektive të çmimit të blerjes së apartamentit. Ky ka qenë kuptimi (konceptimi) im në atë kohë për deklarimin e kursimeve, duke menduar që do të isha më e qartë nëse do të deklaroja kursimet e vitit të përdorura për blerjet e pasurisë [...].*

21.2 Komisioneri Publik, në konsideratë të vendimit orientues të Kolegjit (JR) nr.7/2019, për të vlerësuar zërin e të ardhurave nga paga të siguruara nga puna, si burim për blerjen e pasurisë ap.115 m,<sup>2</sup> Tiranë, ka analizuar të dhënat e deklaruara në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore.

21.3 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime *cash* për herë të parë në DV-2006, si kursime të vitit nga paga për periudhën e punës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda deri në dhjetor të vitit 2006, shumën 1.000.000 lekë<sup>14</sup>.

21.4 Nga përlllogaritja financiare e vitit 2006 rezulton se subjekti nuk mbulon me burime të ligjshme kursimin e deklaruar, me një diferencë negative prej -150.999 lekë<sup>15</sup>.

21.5 Në vlerësim të zërave të deklaruar si burim për krijimin e pasurisë apartament me sip. 115 m<sup>2</sup>, u vlerësua mundësia financiare e subjektit që me të ardhura nga pagat të siguruara nga puna të kryejë pagesën e këstit të parë të apartamentit, në shumën 72.000 euro, më datë 9.10.2009<sup>16</sup>.

21.6 Nga përlllogaritja financiare për periudhën 1.1.2009 deri në 9.10.2009, subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjaftueshmëri financiare, që me kursime nga të ardhurat nga paga të siguruara nga puna, të paguajë këstin e parë të apartamentit, me një diferencë negative prej -376.843 lekë. Subjekti i rivlerësimit, sa më sipër analizuar, rezulton më një diferencë negative totale për pagesën e këstit të parë në shumën -526.843 lekë, përfshirë këtu dhe diferencën negative të konstatuar për kursimet e deklaruara nga paga në vitin 2006.

21.7 Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në DV-2009, ka deklaruar, “*kursime nga paga për periudhën e punës pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për periudhën janar deri në dhjetor të vitit 2009*”, shumën 400.000 lekë.

21.8 Subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin e datës 20.11.2019, ka deklaruar se: [...] *kursimet nga paga të siguruara deri në vitin 2009 (duke përfshirë kursimet e atij viti) i ka zeruar në vitin*

---

<sup>14</sup> Subjekti i rivlerësimit në deklaratën drejtuar Inspektoratit të ILDKPKI-së, së datës 22.1.2015, ndër të tjera, ka pretenduar se në deklarimin periodik të vitit 2006, kam deklaruar kursime nga paga si gjyqtare në shumën 1.000.000 lekë. Kjo shumë e deklaruar nga ana ime është gjendje deri më 31.12.2006 dhe përfaqëson kursimet nga periudha që jam emëruar gjyqtare deri në këtë datë.

<sup>15</sup> Në zërat e përlllogaritjeve financiare për vitin 2006, është marrë në konsideratë si mundësi kursimi *cash* shuma prej 849.001 lekë (1.000.000 – 150.999).

<sup>16</sup> Në përlllogaritjen financiare deri në këtë datë janë përfshirë: (i) kursimet *cash* të deklaruara nga subjekti në DV - 2006-2007-2008, të krijuara me burim nga të ardhurat nga paga, (ii) 250.000 lekë të deklaruara në DV-2007, si të ardhura me burim shitjen e njësisë së shërbimit, si ¼ pjesë takuese, si dhe (iii) të ardhurat nga paga për periudhën 1.1.2009 – 9.10.2009, duke zbritur shpenzimet e jetesës dhe shpenzimet për pagesat e kredisë, të kryera deri në datën 9.10.2009. Kursi i këmbimit është përlllogaritur sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën 9.10.2009.

2009 dhe se kursimet e vitit 2009, pavarësisht se nuk i ka pasur gjendje në datën 31 dhjetor (pasi i ka përdorur për pagesën e këstit) i ka deklaruar, sepse me ato kursime ka likuiduar pjesërisht këstin e blerjes së apartamentit [...].

21.9 Komisioneri Publik, në konsideratë të orientimit të Kolegjit për të mos prezumuar përdorimin nga subjektet të gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike, ka vlerësuar mundësinë financiare të subjektit, që me të ardhura nga paga, të kursejë shumën e deklaruar në fund të vitit 2009.

21.10 Nga përlllogaritja financiare nga data 9.10.2009<sup>17</sup> deri në fund të vitit, 31.12.2009, subjekti i rivlerësimit rezulton me pamjaftueshmëri për të mbuluar me të ardhura të ligjshme kursimin e deklaruar në shumën 400.000 lekë, me një diferencë negative në shumën -252.770 lekë. Nëse kësaj difference i shtojmë rezultatin e analizuar më sipër për periudhën 1.1.2009 - 9.10.2009, diferenca negative e vitit 2009 rezulton në shumën prej - 629.613 lekësh.

21.11 Në përfundim, lidhur burimin e deklaruar, të ardhura nga paga të siguruar nga puna, përdorur për pasurinë “Apartament me sip. banimi 115 m<sup>2</sup>”, vlerësojmë se, në kuptim të nenit D, pika 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, germa “b”, nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm.

**22. Lidhur me zërin: Dhuratë nga prindërit në shumën 15.000 euro (ose 2.057.550 lekë), në vitin 2009, deklaruar si një nga burimet e pasurisë apartament me sip.115 m<sup>2</sup>**

22.1 Subjekti i rivlerësimit, në DV-2009, në zërin “Dhurata dhe trajtime preferenciale” ka deklaruar: [...] *dhuratë nga prindërit \*\*\*,\*\*\* dhe \*\*\*,\*\*\*, në vlerën 15.000 euro. Pa akt noterial, pasi gëzojmë marrëdhënie të posaçme [...].*

22.2 ILDKPKI, në procesverbalin e mbajtur me datë \*\*\*.4.2011, rezulton t’i ketë kërkuar subjektit të paraqesë deklaratë noteriale, që konfirmon dhuratën në shumën 15.000 euro, si dhe të sqarohet në këtë deklaratë burimi i krijimit të këtyre të ardhurave.

22.3 Subjekti i rivlerësimit, bazuar në kërkesën e ILDKPKI-së, ka dorëzuar deklaratën noteriale me nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.4.2011, në të cilën prindërit e subjektit të rivlerësimit, z.\*\*\*.\*\*\* dhe znj.\*\*\*.\*\*\*, deklarojnë: [...] *se në muajin tetor të vitit 2009 i kanë dhuruar vajzës së tyre Etleva Deda shumën prej 15.000 euro, për të plotësuar blerjen e ap. në Tiranë, rr. “\*\*\*.\*\*\*”. Shtetasi \*\*\*,\*\*\* deklarun se, me datë \*\*\*.12.2006, i ka shitur shtetasit \*\*\*,\*\*\* ap. 3+1, ndodhur në katin e 5 (pestë) të ndërtimit, kundrejt çmimit prej 9.000.000 lekë, të reja. \*\*\*,\*\*\* deklarun gjithashtu se, me datë \*\*\*.12.2006, ka blerë një ap. 2+1 në katin e 9-të, ku vlera e blerjes është 5.300.000 lekë të reja. Deklarojmë se shuma prej 15.000 eurosh buron nga diferenca e vlerës së shitjes së ap. të parë dhe vlerës së blerjes së ap. të dytë [...].*

22.4 Komisioneri Publik, në vlerësim të ligjshmërisë së shumës së dhuruar<sup>18</sup>, sipas kërkesave të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, si dhe praktikës të konsoliduar të Kolegjit mbi përkufizimin e të ardhurave të ligjshme si të ardhura të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, paraprkasht konstaton se në dosje të Komisionit nuk dokumentohet pagesa e tatimit për të ardhurat nga dhurimi<sup>19</sup>. Sa më sipër, duket se shuma e dhuruar prej

<sup>17</sup> Datë në të cilën subjekti i rivlerësimit deklarun se ka zeruar të ardhurat për pagesën e këstit të parë të apartamentit.

<sup>18</sup> Subjekti i rivlerësimit, përveç shumës së dhuruar prej 15.000 eurosh, të deklaruar si një ndër burimet për këstin e parë të apartamentit, ka deklaruar se i ati i ka dhuruar në vitin 2011 shumën prej 4.000 euro, të përdorur si burim për pagesën e këstit të dytë të pasurisë.

<sup>19</sup> Referuar nenit 4, germa “i” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe udhëzimit nr. 5, datë 30.1.2006, të Ministrisë së Financave.

15.000 eurosh, nuk plotëson kushtet e të ardhurave të ligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

22.5 Sikundër hetuar dhe nga Komisioni, Komisioneri Publik konstaton se i ati i subjektit të rivlerësimit është në cilësinë e personit të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 13 e ligjit nr. 84/2016, për këtë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, periudhë në të cilën ai ka qenë pjesë përbërëse e gjendjes familjare të subjektit<sup>20</sup>, si dhe person tjetër i lidhur sipas nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, pasi ka pasur marrëdhënie interesi në formën e dhurimit me subjektin e rivlerësimit, për dhurimin e shumës prej 15.000 eurosh, në vitin 2009 dhe 4.000 euro<sup>21</sup> të deklaruar në vitin 2011, si burim për pagesën e këstit të dytë të apartamentit. Sa më sipër, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur i lind detyrimi të provojë ligjshmërinë e shumës së dhuruar. Në rastin konkret, merr rëndësi fakti se vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se një ndër burimet për krijimin e kësaj pasurie kanë qenë të ardhurat e saj nga paga deri në fund të vitit 2004.

22.6 Mundësia për të dhuruar me të ardhura të ligjshme shumën 15.000 euro, në rastin konkret, duket se është e ndërvarur me justifikimin e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë apartament me sip.130 m<sup>2</sup>, të blerë në vlerën 48.000 USD, nga shitja e të cilit është deklaruar dhe burimi i shumës së dhuruar. Kontratat e shitblerjes së pasurive nga i ati, nga diferenca e çmimit të të cilave është deklaruar burimi për shumën prej 15.000 euro, shërbejnë për të provuar ekzistencën e të ardhurave në momentin e dhurimit, por nuk shpjegojnë origjinën e ligjshme të krijimit të kësaj shume.

22.7 Lidhur me burimin e blerjes së apartamentit në Durrës, në vlerën 48.000 USD (dollarë), në datën \*\*\*.8.2003

22.8 Nga aktet në dosje të Komisionit, rezulton se i ati i subjektit të rivlerësimit, përmes kontratës së shitjes me kusht, nr.\*\*\* rep./\*\*\* kol., datë \*\*\*.8.2003, ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. një apartament banimi me sip.130 m<sup>2</sup>, kat i katërt banimi 3+1, në Durrës, për vlerën 48.000 USD (dollarë)<sup>22</sup>.

22.9 Referuar kontratës së shitblerjes, kjo shumë do të likuidohet në këtë mënyrë: (1)kësti i parë, në shumën prej 24.000 dollarë, u likuidua në dorë në zyrën e noterisë Durrës, në praninë e noterit; (2) kësti i dytë, në shumën prej 24.000 dollarë, do të likuidohet gjatë periudhës dyvjeçare, deri në dorëzimin e çelësave në dorë. Referuar deklaratës noteriale të datës 12.5.2020, të dorëzuar nga vetë subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, shtetasi \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e administratorit të vetëm dhe ortak i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., deklaroi se kësti i dytë i apartamentit është paguar në fund të vitit 2004, duke respektuar afatin dyvjeçar të parashikuar në kontratë.

22.10 Vetë subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit, f. 14, ka deklaruar se si burim për blerjen e kësaj prone kanë shërbyer: [...] (i) *Të ardhurat e shtetases Etleva Deda, deri në fund të vitit 2004;* (ii) *të ardhurat e prindërve të mi \*\*\*.\*\*\* dhe \*\*\*.\*\*\*,*

<sup>20</sup> Subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e përbërjes familjare me prindërit dhe motrën deri në korrik të vitit 2017, kur është shpërngulur në Tiranë.

<sup>21</sup> Subjekti i rivlerësimit, në f. 21. të shpjegimeve të rezultateve të hetimit, ka deklaruar se si burim për krijimin e kësaj shume kanë shërbyer të ardhurat e babait nga puna e tij ndër vite, nga aktiviteti privat dyqan dhe shitja e apartamenteve. Nga aktet në dosje rezulton se i ati i subjektit të rivlerësimit, me kontratën nr.\*\*\*, datë \*\*\*.12.2007, i ka shitur shtetasit \*\*\*.\*\*\* Njësinë e shërbimit, në vlerën 1.000.000 lekë. Pjesa tjetër e të ardhurave nga shitja e ap. do të trajtohet në mundësinë e dhurimit të shumës prej 15.000 euro.

<sup>22</sup> I ati i subjektit të rivlerësimit, me kontratën nr.\*\*\* rep./\*\*\*, datë \*\*\*.12.2006, këtë pasuri ia shet shtetasit \*\*\*.\*\*\*, me çmimin prej 9.000.000. lekë. Këto dy pasuri nuk janë të regjistruara në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

*deri në fund të vitit 2004; (iii) të ardhurat e sime motre, shtetases \*\*\*.\*\*\*, për periudhën janar 1994 - gusht 2000<sup>23</sup>[...].*

22.11 Komisioni, pasi ka vlerësuar aktet dhe shpjegimet e subjektit, ka konkluduar se: [...] *Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shpjegime dhe prova të mjaftueshme lidhur me ligjshmërinë e shumës prej 15,000 euro, të dhuruar nga prindërit në vitin 2009, duke provuar mundësitë e tyre financiare për blerjen e apartamentit në Durrës në vitin 2003 dhe detyrimin për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e tij në vitin 2006 [...].*

22.12 Komisioneri Publik, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, i është referuar mundësisë financiare të blerjes së kësaj pasurie me të ardhura të ligjshme, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur/të tjerë të lidhur, në dy periudha sipas kalendarit të kryerjes së kësteve të pagesave. Të ardhurat e realizuara nga aktiviteti i biznesit të prindërve janë përlllogaritur me të njëjtën normë fitimi të qarkullimit të realizuar, siç është pretenduar nga vetë subjekti i rivlerësimit në rezultatet e hetimit, si dhe ka përdorur dhe Komisioni në analizën e tij.

22.13 Bazuar në përlllogaritjet përkatëse, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur/ të tjerë të lidhur rezultojnë me mungesë të të ardhurave të ligjshme në shumën totale prej 12.332 USD, për të blerë pasurinë apartament me sip.130 m<sup>2</sup>, Durrës, me çmim blerje 48.000 USD, pasuri e cila ka shërbyer si burim për krijimin e shumës së dhuruar prej 15.000 eurosh, për blerjen e apartamentit në pronësi të subjektit, në Tiranë.

22.14 Komisioneri Publik, si konkluzion për sa më sipër, vlerëson se personat e lidhur/tjerë të lidhur, duket se nuk kanë shpjeguar në mënyrë të besueshme origjinën e ligjshme të shumës prej 15.000 euro, pasi nuk provohet me dokumentacion ligjor në kuadër të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, aftësia financiare e tyre, që me burim nga të ardhura të ligjshme, të posedonin këtë shumë të deklaruar si burim për pagesën e këstit të parë të pasurisë apartament me sip. 115 m<sup>2</sup>.

**23.** Në përfundim, **Komisioneri Publik**, mbështetur në konkluzionet e mësipërme mbi vlerësimin e kriterit të pasurisë, vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet dhe kursimet, e klasifikon subjektin e rivlerësimit në situatën e parashikuar nga neni D, pikat 1, 3 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës dhe neni 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**24.** Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, duke marrë për bazë jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjendjen e fakteve dhe provave në rastin konkret dhe të ligjit të zbatueshëm, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë;

---

<sup>23</sup> Në dosjen e Komisionit janë administruar: (i) Vërtetim nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të ardhurat e subjektit për periudhën 1993 – 2000; (ii) Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare për periudhën 1.3.2000 – 31.12.2002 dhe 1.1.2003 – 29.2.2004; (iii) Vërtetim page nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.1.2017, i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, për vitet 2004 – 2017; (iv) Shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2016, e D.R.Tatimore Durrës; (v) Shkresa nr.\*\*\* prot., datë \*\*\*.3.2019, e D.R.Tatimore Durrës.

**25.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

**26.** Bazuar në nenet Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, nenin 4 dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016;

**27.** Komisioneri Publik kërkon, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 256, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Etleva Deda.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**